



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 08.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.04.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Botek SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS"** me Nr. të Prok: 206-23-571-2-1-1 nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Botek SH.P.K. të dt.28.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS", me Nr. të Prok: 206-23-571-2-1-1, kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK*, të datës 24.04.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Mbetet në fuqi**, Njoftimit mbi Vendimin e AK, i publikuar me datë: 24.04.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Botek SH.P.K. me datë 28.04.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS", me Nr. të prokurimit: 206-23-571-2-1-1. Autoriteti Kontraktues menjëherë është marrë me shqyrtimin e kërkesës në fjalë dhe në bazë të rekomandimit profesional nga Njesia e kërkesës – Departamenti i SISH-it në MSh, sot e datën 08.05.2023, vendosi si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE Botek SH.P.K.:

***Neni 1 i LPP Nr. 04/L-042 Qëllimi***

***Neni i LPP Nr. 04/L-042 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti***

***Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi***

*Neni 28 i LPP Nr. 04/L-042 Specifikimet teknike*

*Neni 51 i LPP Nr. 04/L-042 Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes*

*Neni 59 i LPP Nr. 04/L-042 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

*Neni 60 i LPP Nr. 04/L-042 Kriteret për Dhënien e Kontratës*

*Neni 72 i LPP Nr. 04/L-042 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

### **Pretendimi ankimor**

Përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim, ne atakojmë vendimin tuaj, me të cilin keni eliminuar tenderin nga gara në procedurën e prokurimit, si të padrejtë dhe gjithsesi i pabazuara në asnjë nen të LPP. Ne me përgjegjësi të plotë Ri-konfirmojmë se tenderi i dorëzuar nga ne si GOE, i përmbushë pa përjashtim, të gjitha kriteret administrative dhe teknike, sipas Dosjen e Tenderit, dhe sqarimeve shtesë të dhëna nga ju si AK.

Më poshtë, do faktojmë me prova që pretendimet tuaja me të cilat na keni shpallur të eliminuar, janë të pabazura plotësisht dhe tendencioze:

1. Kërkesa 1. - Referenca që konzorciumi ynë ka paraqitur, lidhet edhe me HIS, pasi që Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka lidhshmëri të ngushtë me sistemin informativ shëndetësor dhe një projekt i tillë, gjithsesi se duhet të merret parasysh edhe nga ju si AK.

Sistemi HIFIS është sistem shumë dimenzional, i cili përveç pjesës së administrimit dhe menaxhimit me pjesën financiare është ngushtë i lidhur me sistemin shëndetësor, duke ofruar shërbime të ndryshme për të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësorë, prandaj edhe është pjese e projektit të shëndetësisë Kosovare dhe nuk mund të konsiderohet për interesa të caktuara se nuk është pjese e shëndetësisë Kosovare.

Ne vijim po i paraqesim vetëm tri pika përmes të cilave sistemi HIFIS është i ndërlidhur ngushtë me sistemin shëndetësorë në të gjitha nivelet:

- Përmes ofrimit të shërbimit të statusit të pacientit - shërbim i cili përfshin hapin e parë në sistemin shëndetësorë pa këtë sistem nuk ka kuptim në ofrimin shërbimit në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.

- Përmes e-Recetes - e cila përmban informacionet që përshkruhen nga mjeket në të gjitha nivelet shëndetësore për pacientet që paraqiten. Brenda sistemit HIFIS është sistemi e-Recetë i cili është i sinkronizuar me Farmacitë (Sistemi për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik – SMSF) dhe Qendrën Mjekësore – Staf Mjekësor (Sistemi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore HRSMSH).

- Përmes validimit të shërbimeve që ofrohen nga Institucionet Shëndetësore - Ndërlidhja me të gjitha nivelet e sistemit për të ofruar shërbimet e shëndetësore dhe validimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore duke filluar nga Institucionet shëndetësore, stafi shëndetësor, shërbimet e standardeve ICD 10, etj.

Për më shumë, gjeni bashkëlidhur dhe dokumentin me sqarimet e mëtejshme lidhur me projektin HIFIS, duke dëshmuar që ky projekt ka lidhshmëri të ngushtë edhe me Health Information System dhe është një referencë e vlefshme. Dokumenti "HIFIS System Connection".

2. Kërkesa 2- Sqarim: Edhe tek pika 2 e arsyetimit tuaj për të eliminuar tenderin tonë nuk qëndron fare, për shkak se ne kemi dëshmuar me listë të kontratave dhe referencave, që të gjithë anëtarët e konzorciumit (veç e veq) kanë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e sistemeve të raportimit, të paktën në një (1) apo me shumë organizata me mbi 100 punonjës.

a. Teched Ltd. si anëtar i konzorciumit në listën e projekteve të realizuara të cilën e kemi listuar dhe dorëzuar me tender, ka zhvilluar disa sisteme, në disa entitete të ndryshme me më shumë se 100 punonjës, përmes të cilave sisteme, përdoruesit e fundit përpilojnë raporte dinamike të nxjerra nga sistemi! (Referenca: nr. 2, 5 & 7).

b. Edusoft Ltd, gjithashtu si anëtar i konzorciumit, nga lista e projekteve të realizuara të cilat i kemi prezantuar me tender, ka zhvilluar projekte të mëdha, në të cilat përfshihen edhe module të raportimit, sikurse projekti i financuar nga USAID në Maqedoni. Pjesë e këtij projekti ka qenë edhe zhvillimi i modulit për krijim të raporteve, i cili është përdorur nga 2200 përdorues, (Referenca: nr. 3).

c. Botek shpk si liderë e këtij konsorciumi ka zhvilluar modulën për regjistrim të mësimdhënësve dhe studentëve në mësim (Universiteti i Prishtinës), i cili përveç tjerash ka edhe funksionin e përpunimit të raporteve për më shumë se 2000 persona. (Referenca: nr 1, 4, 6 & 8 ). Ndërsa për kontratat të listuara në numrin 6 dhe 8, ato janë kontrata konfidenciale (nivele Sekret) me Policinë e Kosovës dhe për to mund të merren informata dhe referencë, vetëm me leje paraprake nga Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosovës, ashtu sikurse e kemi cekur edhe në listën e kontratave. Prandaj, ju si AK keni pas dhe keni mundësi të kontaktoni direkt personat përgjegjës (PM e Kontratave) që ne i kemi vendosur në listën e kontratës pranë AK (Policia e Kosovës) dhe të kërkonim çfarëdo konfirmimi i që ju nevojitet për të Ri-konfirmuar të gjitha deklaratimet tona me shkrim, prapa të cilave qëndrojmë me përgjegjësi penale.

3. Kërkesa 3a. Një Menaxher i Projektit: z. Lazar Adjugogov është i diplomuar në nivelin Master of Science në vitin 2004, në Institutin e Rrjetëve të Informacionit (INI) në Universitetin Carnegie Mellon (CMU) – USA (Pensilvania). Ky institut edukon dhe zhvillon inxhinierë përmes programeve të Master Teknik, ndërdisiplinor në rrjetet e informacionit, sigurinë dhe inxhinierinë celulare dhe IoT që përfshijnë perspektiva të biznesit dhe politikave. Për më tepër z. Adjugogov, ka të përfunduar Studimet pesëvjeçare (5) në vitin 2003 në Inxhinierinë Elektrike drejtimi “Teknologji kompjuterike, Informatikë dhe Automatizëm” (Në rast se ju e kerkoni për ta deshmuar kualifikimin baze ne mund t’ua percejellim edhe Diplomen perkatese ne Maqedonisht dhe perkthimi ne gjuhen Shqip/Angleze)

Z. Lasar Adjugogov posedon Certifikatën valide PMP (Project Management Profesional) të cilën e kemi dorëzuar me tender. I njëjti ka përvojë 19 vjeçare në menaxhimin e projekteve të mëdha (17 projekte) të cilat janë të Listuara në ffirmimin nga Punëdhënësi EDUSOFT, gjithashtu të dorëzuar me tender.

Kërkesa 3d Dhjetë (10) Ekspert për trajnime dhe On-site Support Z. Edon Selimi ka të përfunduar studimet në “Bachelor i Shkencave të TI”. Kjo mund të shihet edhe në dokumentin e prezantuar me dosjen e tenderit ku kemi qartësuar se z. Edon Selimi ka të drejtën për të fituar titullin Inxhinier i diplomuar i TI-ve dhe posedon Diplomë. Po ashtu, kjo e Ri konfirmohet edhe në aktin noterial, (i dorëzuar bashkë me Certifikatën) ku shkruan qartë se: “Certify that this is copy of the original-of the certified copy of:

diploma”. Kjo dhe çfarëdo paqartësie do të mund të sqarohet me Kërkesën për Sqarime të tenderit, sikurse lejohet me LPP neni 72. Për ta Ri konfirmuar këtë ju lutem gjeni të bashkangjitur edhe Diplomën e lëshuar nga “International Balkan University” – Skopje, Faculty of Engineering i cili dëshmon se z. Edon Selimi posedon Diplomë Universitare. Për më tepër të Certifikata e dorëzuar shkruan se: “Integral part of this Certificate is also the Certificate of passed exams” dhe nëse përkthehet në shqip thotë:

“Pjesë përbërëse e kësaj Certifikate është po ashtu Certifikata e provimeve të dhëna” Dhe jo ashtu sic e kemi interpretuar ju në Vendimin e AK-së, “... Certifikata e provimeve të mbetura”. Edhe numri i kredive të konfirmuara në këtë Certifikate, 240 Kredi, tregon nivelin e shkollimit.

Për sa i përket personave: Gazmend Haxhijaha, Goran Mitev, Ljupcho Tagarovski dhe Sonja Dimovska, sipas Dosjes së tenderit dhe sqarimeve shtese, vetëm për trajnerët të cilët kanë kualifikime të ntyrave tjere është kërkuar që ta dëshmojnë me ndonjë certifikatë specifike se të njëjtit janë të trajnuar për të ofruar trajnime dhe on-site support. Përdërisa, në Dosjen Tenderit kërkohej dëshmi:

Vendimi për Cilësinë e angazhimit, 1. Letër Referencë nga punëdhënësi dhe 2. Kopja e motorizuar e diplomës universitare, dokumente këto të cilat ne i kemi dorëzuar për secilin person veq e veq.

Rrjedhimisht ky pretendim i juaji për sa i përket personave si me lart, nuk është i bazuar dhe nuk qëndron.

Me sqarimet e publikuara nga ju si AK, me datë 16.02.2023, ju keni theksuar se:

Inxhinierët e elektroteknikës që kanë ndjekur studimet pesëvjeçare dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet master nuk kanë nevojë të posedojnë këtë certifikatë (e njëjta logjikë vlen për të gjitha pozicionet e tjera).

Pra sipas këtyre sqarimeve, inxhinierët e diplomuar në studimet pesëvjeçare nuk kanë nevojë të posedojnë certifikatë dhe rrjedhimisht edhe znj. Gyltene Tafa i përmbush plotësisht kriterin “Një Ekspert për kontrolle të Cilësisë.

Për znj. Sonja Dimovska: Sikurse edhe kemi deponuar me tenderin tonë, po e ri konfirmojmë se znj. Sonja Dimovska ka titullin e Inxhinieres Elektrike e diplomuar, në sistem 5 vjeçar.

Në dosjen e tenderit ne e kemi paraqitur përkthimin në gjuhën angleze, pasi që Diploma Bachelor është në gjuhën Maqedonase. - Ndërsa tek akti noterial mund të shihet qartë se ky dokument është noterizimi i diplomës së lëshuar me datë 26.12.1994 (citat:I acknowledge that this is ? ??? of the original document Bachelor Degree issued ?n

26.12.1994), që ndërlidhet me datën kur është lëshuar diploma për znj. Dimovska.

Noterizimi i diplomës është kërkuar nga z. Gazmend Haxhijaha dhe për këtë arsye edhe figuron emri i z. Haxhijaha në aktin noterial.

Gjithsesi dhe kjo do të mund të sqarohet me Kërkesën për Sqarime të tenderit nga ju si AK, sikurse lejohet me LPP neni 72.

4. Kërkesa 3e. Një (1) Ekspert për Kontrollë të Cilësisë.

z. Damjan Radicevic është i certifikuar ISTQB Certified Tester – Advanced Level 2012- Test Manager. ISTQB është standard botëror për kualifikimin profesional të testuesve të softuerëve.

Kjo certifikatë nuk ka nevojë të noterizohet, pasi që e njëjta mund të vërtetohet online përmes QR kodit, po ashtu sikurse edhe kërkohet në Dosjen e tenderit – “mundësia e verifikimit online” dhe se ju si AK keni mundësi në çdo kohë të bëni verifikimin e kësaj Certifikatë dhe se pretendimi i juaj është tendencioz dhe NUK qëndron.

Përveç kësaj, ne kemi angazhuar si Ekspert për Kontrolle të Cilësisë edhe znj. Gyltene Tafa, e cila është Inxhinierë e diplomuar e Elektroteknikës. Znj. Tafa ka ndjekur studimet themelore universitare sipas sistemit para-Bolonjës, sistemi pesëvjeçar.

Me sqarimet e publikuara nga ju si AK, me datë 16.02.2023, ju keni theksuar se: Inxhinierët e elektroteknikës që kanë ndjekur studimet pesëvjeçare dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet master nuk kanë nevojë të posedojnë këtë certifikatë (e njëjta logjikë vlen për të gjitha pozicionet e tjera).

Pra sipas këtyre sqarimeve, inxhinierët e diplomuar në studimet pesëvjeçare nuk kanë nevojë të posedojnë certifikatë dhe rrjedhimisht edhe znj. Gyltene Tafa i përmbush plotësisht kriterin “Një Ekspert për kontrolle të Cilësisë.

Pretendimi i AK tek Specifikat teknike të DT – Aneksi 1

“AK- gëzon të drejtën të kërkojë nga OE në afatin përcaktuar në këtë dokument që të krijoj edhe modulet dhe shërbime shtese pa asnjë kufizim në kosto, apo afat kohor.

- Referuar Ofertës tuaj nuk ofrohet kjo mundësi, oferta juaj gjatë gjithë kohës ndërlidhet që do të krijoj Sistem të ri, gjë që është në kundërshtim me kërkesën e AK-se dhe nuk mund të pranohet si zgjidhje. Në ofertë është specifikuar që AK e gëzon të drejtën të kërkojë nga OE në afatin përcaktuar që të krijojë edhe modulet dhe shërbime shtesë pa asnjë kufizim në kosto, apo afat kohor”.

Përgjigja:

Nuk qëndron. Ne nuk kemi dhënë ofertë teknike për krijim të një sistemi të ri, përpos moduleve të reja që janë kërkuar për zhvillim (zhvillimet e reja), kemi dhënë zgjidhjen dhe planin dinamik për kohës që do të krijojmë, ndërsa për sistemin ekzistues jemi zotuar me zgjidhjen që kemi dhënë se do avancojmë

(zhvillojmë) sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe do të ofrojmë mirëmbajtjen për 36 muaj (shih rreshtin e fundit të tabelës së Planit Dinamik tek propozimi teknik i mirëmbajtjes dhe avancimit). Pretendimi i AK: Prioritet 4 – “zhvillimi i moduleve të reja jo me vone se 20 dite pune. - Sipas Ofertës tuaj ju kemi ofruar zhvillim vetëm vitin e parë, gjë që është në kundërshtim me kërkesën e AK-se, sipas DT kërkohet që behet Zhvillim gjatë gjithë kohës sipas kërkesës së AK-se. Referuar Kërkesës së AK se kërkohet Avancim dhe mirëmbajtje e sistemit ekzistues pa ndryshuar natyrën dhe metodologjinë gjë që kjo oferte rezulton me ndryshim nga Objektivi i projektit, ndërsa referuar ofertës tuaj rezulton se kemi ofruar që sistemi të zhvillohet nga Fillimi gjë që është në kundërshtim të plote me kërkesën e AK-se pasi modulet ekzistuese vetëm janë në përdorim dhe nga të njëjtët ofrohen shërbime pa ndërprerë, andaj nga MSh nuk është kërkuar që të ndryshoi sistemi, kjo është e Specifikuar edhe tek qëllimi i projektit "Mirëmbajta dhe Avancim e zgjidhjes ekzistuese". Referuar Ofertës Teknike ndër të tjera kemi deklaruar se do të ofroni një sistem softuerik... gjë që është në kundërshtim të plote me kërkesat e AK-se dhe dëshmon qartë se OE nuk ka ofertuar për Mirëmbajtjen dhe Avancimin e këtij sistemi mirëpo me qëllimin e krijimit të një Sistemi të Ri, kjo gjë me detajsh të është e qartësuar në faqe 48 tek Propozimi Teknik i ofertës së OE. Referuar ofertës suaj përkatësisht faqe 62 dhe 63 vërehet qartë se ju nuk do të avancohen sistemin siç është përshkruar në dosje të tenderit, pasi referuar Planit dinamik në faqe 63, ku potencohet se do të ofroj mirëmbajtje 36 muaj dhe nuk do të ofroj avancim në zgjidhjen ekzistuese, andaj plani dinamik i propozuar dëshmon një gjë të tillë”.

Përgjegjia-4:

Edhe ky pohim nuk qëndron. Ne nuk kemi dhënë zgjidhje për zhvillim vetëm për 20 dite pune dhe as nuk kemi ofertuar për krijimin e një sistemi të ri. Ne kemi dhënë ofertën për zhvillime, avancime dhe mirëmbajtje të sistemit ekzistues për 36 muaj sipas kërkesave në dosjen e tenderit. Sa i përket pretendimit tuaj se ne kemi deklaruar se ofrojmë sistem softuerik, “... tjera kemi deklaruar se do të ofroni një sistem softuerik...” në bazë edhe të cilit pretendim kemi ardhur në përfundim se ne do të ofrojmë sistem të ri, nga faqja 48 e zgjidhjes të teknike, Ky pretendim i juaji është i pavërtet dhe tendencioz. Ne në faqen 48 të 7. Propozimi Teknik dhe Plani i mirëmbajtjes BHIS, falsim për Mirëmbajtjen dhe procesin e mirëmbajtjes, dhe jo për zhvillimin e një sistemit të ri.

Nga faqja 48, Mirëmbajtja:

*Gjatë kësaj periudhe, Kontraktuesi do të identifikoj dhe zgjidhë problemet për të siguruar funksionimin adekuat të sistemit. Kontraktuesi duhet të ofroj një sistem softuerik, efektiv për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale.*

*Gjatë kësaj periudhe, Grupi i Operatorëve Ekonomik deklaroi se do të identifikoj dhe do të zgjidhë problemet për të siguruar funksionimin adekuat të sistemit. Grupi i Operatorëve Ekonomik do të ofroj një sistem softuerik, efektiv për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale.*

Pra në mënyrë që të ofrojmë mirëmbajtje me efektive për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale, ashtu siç kemi kërkuar ju vendimisht në dosjen e tenderit faqe 24 e dosjes së tenderit, ne do të kemi një sistem softuerik për Mirëmbajtje, dhe kjo nuk ka të bëjë fare me vetë Aplikacionin e BHIS

Pjesë nga faqja 24 e dosjes së tenderit:

*13. Mirëmbajtja Kontraktuesi do të sigurojë mbështetje dhe mirëmbajtje pas lançimit të suksesshëm të çdo pjesë të sistemit, për aq kohë sa posedon Kontrate Aktive. Gjatë kësaj periudhe, Kontraktuesi do të identifikoj dhe zgjidhë problemet për të siguruar funksionimin adekuat të sistemit. Kontraktuesi duhet të ofroj një sistem softuerik, efektiv për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale. Operatori Ekonomik është i detyruar të sigurojë një prezencë fizike kur është e nevojshme për të eliminuar ndonjë mangësi apo parregullsi të sistemit*

Bashkangjitur keni Excel Fajllin me titull "Plani i realizimit te projektit BHIS sipas kerkesave.xlsx" që e keni të inkuorporuar në propozimin teknik referuar ofertës sonë përkatësisht faqeve 62 dhe 63 vërehet qartë nuk qëndron se ne nuk do te avancojmë sistemin siç është përshkruar ne dosje te tenderit, por edhe referuar Planit dinamik ne faqe 63 mund ta vëreni në planin dinamik në Excel Fajll të zhvillimeve, avancime dhe mirëmbajtjes, se çdo fazë në kuadër të 36 muajve është konfom dosjes së tenderit si në vijim:

## PLANI DINAMIK I REALIZIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PROJEKTIT

"Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS":

1. Nën-sistemi i pranimit: (Avancim dhe Mirëmbajtje) 10 muaj, vazhdon pastaj me ngjyrë të gjelbërt mirëmbajtja deri në fund të projektit pas zhvillimit dhe avancimeve për muajt e mbetur deri në përfundim të 36 muajve sa do të zgjatë projekti/kontrata.
2. Nën-sistemi i shërbimeve shëndetësore (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
3. Nën-sistemi i shërbimeve të infermierisë (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
4. Nën-sistemi i administrimit të sistemit (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
5. Nën-sistemi i faturimit (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
6. Nën-sistemi i raportimit (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
8. Nën-sistemet shtesë (Zhvillimi dhe Mirëmbajtje) Të gjitha Nën-sistemet shtesë (Faqe 22 dhe 23 në dosjen e tenderit) do të zhvillohet pasi të gjitha këto module të specifikohen në detaje gjatë implementimit të sistemit në bashkëpunim me Departamentin e SISH për të vazhduar zhvillimin e sistemit pas versionit të pare, siç është kërkuar në dosjen e tenderit brenda periudhës së kontratës 36 mujore.
9. Sistemi i raportimeve - Inteligjenca e biznesit (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me ngjyre të verdhë në Excel fajll.
10. Mirëmbajtja e sistemit (mirëmbajtja do të ofrohet për 36 muaj për sistemin ekzistues, për të gjitha avancimet e moduleve dhe nën-sistemet dhe modulet dhe nën-sistemet e reja të zhvilluara), referojuni ngjyrës së gjelbërit në Excel fajll për 36 muaj mirëmbajtje për tërë sistemin ekzistues dhe modulet e krijuara që do zhvillohen të reja dhe avancimet.

Prandaj, bazuar në të gjitha sqarimet që u dhanë më lartë, të bazuara gjithmonë me prova materiale, mund të konstatojmë që vendimi juaj i datës 25.04.2023 është i jashtëligjshëm.  
Prandaj, kërkojmë nga ju që të anuloni vendimin e datës 25.04.2023 dhe lëndën ta ktheni në rivlerësim.

### Dëmet materiale

Humbja e fitimit të parashikuar nga kontrata, pamundësia për pjesëmarrje të barabartë në Aktivitet të prokurimit.

## **Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE**

### **Pretendimi i parë:**

Më poshtë, do faktojmë me prova që pretendimet tuaja me të cilat na keni shpallur të eliminuar, janë të pabazura plotësisht dhe tendencioze:

kërkesa 1. - Referenca që konzorciumi ynë ka paraqitur, lidhet edhe me HIS, pasi që Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka lidhshmëri të ngushtë me sistemin informativ shëndetësor dhe një projekt i tillë, gjithsesi se duhet të merret parasysh edhe nga ju si AK.

Sistemi HIFIS është sistem shumë dimenzional, i cili përveç pjesës së administrimit dhe menaxhimit me pjesën financiare është ngushtë i lidhur me sistemin shëndetësor, duke ofruar shërbime të ndryshme për të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësorë, prandaj edhe është pjese e projektit të shëndetësisë Kosovare dhe nuk mund të konsiderohet për interesa të caktuara se nuk është pjese e shëndetësisë Kosovare.

Ne vijim po i paraqesim vetëm tri pika përmes të cilave sistemi HIFIS është i ndërlidhur ngushtë me sistemin shëndetësorë në të gjitha nivelet:

- Përmes ofrimit të shërbimit të statusit të pacientit - shërbim i cili përfshin hapin e parë në sistemin shëndetësorë pa këtë sistem nuk ka kuptim në ofrimin shërbimit në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.
- Përmes e-Recetes - e cila përmban informacionet që përshkruhen nga mjeket në të gjitha nivelet shëndetësore për pacientet që paraqiten. Brenda sistemit HIFIS është sistemi e-Recetë i cili është i sinkronizuar me Farmacitë (Sistemi për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik – SMSF) dhe Qendrën Mjekësore – Staf Mjekësor (Sistemi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore HRSMH).
- Përmes validimit të shërbimeve që ofrohen nga Institucionet Shëndetësore - Ndërlidhja me të gjitha nivelet e sistemit për të ofruar shërbimet e shëndetësore dhe validimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore duke filluar nga Institucionet shëndetësore, stafi shëndetësor, shërbimet e standardeve ICD 10, etj.

Për më shumë, gjeni bashkëlidhur dhe dokumentin me sqarimet e mëtejshme lidhur me projektin HIFIS, duke dëshmuar që ky projekt ka lidhshmëri të ngushtë edhe me Health Information System dhe është një referencë e vlefshme. Dokumenti “HIFIS System Connection”.

### Përgjigjia në ankesë:

E ritheksojmë se kërkesa ka qenë “Operatori Ekonomik duhet të ketë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e të paktën 1 (një) projekti për Health Information System, për të paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë” dhe jo për sisteme që mund të lidhen ose shkëmbejnë informata me Sistem Informativ Shëndetësor. Gjithashtu ju informojmë se edhe gjatë fazës së Sqarimeve shtesë nuk është parashtruar asnjë kërkesë për sqarime shtesë për këtë pjesë.

Referuar përshkrimit të këtij projekti: Aneks i këtij Dokumenti gjeni Termat e Referencës për këtë projekt i cili tregon Sakt Scopin e këtij projekti, me çka është komplet Sistem i ndryshëm me Health Information System sipas kërkesës.

### **Për sqarim:**

HIS: I referohet një sistemi të dizajnuar për të menaxhuar me të dhënat shëndetësore, duke përfshinë mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, menaxhimin, transmetimin dhe raportimin e të dhënave të nevojshme për përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të shërbimit shëndetësor përmes menaxhimit më të mirë në të gjitha nivelet e shërbimeve shëndetësore dhe duke mundësuar dosje elektronike shëndetësore për secilin qytetar.

Rrjedhimisht keni ofruar listën e kontratave, por asnjëra nga referencat nuk e përmbush kërkesën për (një) projekti për Health Information System, për të paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë (Parësor, Sekondar ose Terciar). Referenca e dorëzuar nga MSH-Banka Botërore, për projektin "System platform for HIS information System" ka të bëjë me Sistemin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe nuk ka fare të bëjë me Health Information System.

D.m.th. projekti HIFIS ka të bëjë me menaxhimin e proceseve për rimbursimet buxhetore dhe proceseve të brendshme të Fondit të Sigurimeve, ndërsa referenca e kërkuar nga MSH për HIS i dedikohet pjesës shëndetësore.

#### **Pretendimi i dytë**

Kërkesa 2- Sqarim: Edhe tek pika 2 e arsyetimit tuaj për të eliminuar tenderin tonë nuk qëndron fare, për shkak se ne kemi dëshmuar me listë të kontratave dhe referencave, që të gjithë anëtarët e konsorciumit (veç e veç) kanë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e sistemeve të raportimit, të paktën në një (1) apo me shumë organizata me mbi 100 punonjës.

a. Teched Ltd. si anëtar i konsorciumit në listën e projekteve të realizuara të cilën e kemi listuar dhe dorëzuar me tender, ka zhvilluar disa sisteme, në disa entitete të ndryshme me më shumë se 100 punonjës, përmes të cilave sisteme, përdoruesit e fundit përpilojnë raporte dinamike të nxjerra nga sistemi! (Referenca: nr. 2, 5 & 7).

b. Edusoft Ltd, gjithashtu si anëtar i konsorciumit, nga lista e projekteve të realizuara të cilat i kemi prezantuar me tender, ka zhvilluar projekte të mëdha, në të cilat përfshihen edhe module të raportimit, sikurse projekti i financuar nga USAID në Maqedoni. Pjesë e këtij projekti ka qenë edhe zhvillimi i modulit për krijim të raporteve, i cili është përdorur nga 2200 përdorues, (Referenca: nr. 3).

c. Botek shpk si liderë e këtij konsorciumi ka zhvilluar modulën për regjistrim të mësimdhënësve dhe studentëve në mësim (Universiteti i Prishtinës), i cili përveç tjerash ka edhe funksionin e përpunimit të raporteve për më shumë se 2000 persona. (Referenca: nr 1, 4, 6 & 8).

Ndërsa për kontratat të listuara në numrin 6 dhe 8, ato janë kontrata konfidenciale (nivele Sekret) me Policinë e Kosovës dhe për to mund të merren informata dhe referencë, vetëm me leje paraprake nga Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosovës, ashtu sikurse e kemi cekur edhe në listën e kontratave.

Prandaj, ju si AK keni pas dhe keni mundësi të kontaktoni direkt personat përgjegjës (PM e Kontratave) që ne i kemi vendosur në listën e kontratës pranë AK (Policia e Kosovës) dhe të kërkonit çfarëdo konfirmimi i që ju nevojitet për të Ri-konfirmuar të gjitha deklaratimet tona me shkrim, prapa të cilave qëndrojmë me përgjegjësi penale.

#### Përgjigja në ankesë:

E ritheksojmë, se asnjëra nga referencat e dorëzuara nuk e përmbush kërkesën për dy (2) sistemeve të raportimit. Në referencat e dorëzuara, askund nuk shkruan që ka sisteme të raportimit. Ndërsa për referencat me numër rendor 6 dhe 8 Dëshmia e kërkuar ka qenë (raport pranimit ose referencë nga autoriteti kontraktues), jo kontakte të Menaxherëve të Projekteve nga Autoritet Kontraktues.

Përveç kësaj, nëse kontratat kanë qenë sekret siç e keni specifikuar, mendojmë që të njëjtat nuk do duhej ti paraqitni as në listë të kontratave e aq më pak të bëhet përshkrimi për to.



### **Pretendimi i tretë**

Kërkesa 3a. Një Menaxher i Projektit: z. Lazar Adjigogov është i diplomuar në nivelin Master of Science në vitin 2004, në Institutin e Rrjeteve të Informacionit (INI) në Universitetin Carnegie Mellon (CMU) – USA (Pensilvania). Ky institut edukon dhe zhvillon inxhinierë përmes programeve të Master Teknik, ndërdisiplinor në rrjetet e informacionit, sigurinë dhe inxhinierinë celulare dhe IoT që përfshijnë perspektiva të biznesit dhe politikave. Për më tepër z. Adjigogov, ka të përfunduar Studimet pesëvjeçare (5) në vitin 2003 në Inxhinierinë Elektrike drejtimi “Teknologji kompjuterike, Informatikë dhe Automatizëm” (Në rast se ju e kerkoni për ta deshmuar kualifikimin baze në mund t’ua percjellim edhe Diplomen perkatese në Maqedonisht dhe përkthimi në gjuhën Shqipe/Angleze)

Z. Lazar Adjigogov posedon Certifikatën valide PMP (Project Management Profesional) të cilën e kemi dorëzuar me tender. I njëjti ka përvojë 19 vjeçare në menaxhimin e projekteve të mëdha (17 projekte) të cilat janë të Listuara në fonfirmimin nga Punëdhënësi EDUSOFT, gjithashtu të dorëzuar me tender.

#### Përgjigja në ankesë:

**E ritheksojmë, keni ofertuar me Lazar Adjigogov për të cilin keni dorëzuar diplomën në drejtimin Informatikan Networking. Drejtim ky që nuk e përmbush kërkesën e njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit, përfshi formularin standard B54 si dokumenti final për vlerësim të ofertave.**

**Po ashtu, diploma Inxhinierinë Elektrike për të cilën keni thënë që e posedon i njëjti nuk e përmbush kërkesën e njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit, përfshi sqarimet shtesë dhe formularin standard B54.**

**Kërkesa në njoftimin për kontrate dhe në dosje të tenderit, përfshi sqarimet shtesë dhe formularin standard B54, ka qenë” Të jetë i diplomuar në shkencë kompjuterike dhe Ose inxhinieri softuerike”, jo në inxhinieri elektrike.**

**Në nuk e kemi mohuar certifikimin e të njëjtit, por diplomën e cila nuk e përmbush kërkesat e njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit.**



# CARNEGIE MELLON UNIVERSITY

UPON THE RECOMMENDATION OF THE FACULTY  
HEREBY CONFERS ON

**LAZAR ADZIGOGOV**

THE DEGREE OF

**MASTER OF SCIENCE**

IN RECOGNITION OF THE COMPLETION OF THE COURSE OF STUDY PRESCRIBED FOR THE FIELD(S) OF

**INFORMATION NETWORKING**

GIVEN UNDER THE SEAL OF THE CORPORATION OF PITTSBURGH  
IN THE COMMONWEALTH OF PENNSYLVANIA  
ON THE 23RD DAY OF DECEMBER, 2004

*Debra A. ...*  
DEBRA A. ...

*...*

## **Pretendimi i katërt**

Kërkesa 3d Dhjetë (10) Ekspert për trajnime dhe On-site SupportZ. Edon Selimi ka të përfunduar studimet në "Bachelor i Shkencave të TI". Kjo mund të shihet edhe në dokumentin e prezantuar me dosjen e tenderit ku kemi qartësuar se z. Edon Selimi ka të drejtën për të fituar titullin Inxhinier i diplomuar i TI-ve dhe posedon Diplomë. Po ashtu, kjo e Ri konfirmohet edhe në aktin noterial, (i dorëzuar bashkë me Certifikatën) ku shkruan qartë se: "Certify that this is copy of the original-of the certified copy of: diploma". Kjo dhe çfarëdo paqartësie do të mund të sqarohet me Kërkesën për Sqarime të tenderit, sikurse lejohet me LPP neni 72. Për ta Ri konfirmuar këtë ju lutem gjeni të bashkangjitur edhe Diplomën e lëshuar nga "International Balkan University" – Skopje, Faculty of Engineering i cili dëshmon se z. Edon Selimi posedon Diplomë Universitare. Për më tepër te Certifikata e dorëzuar shkruan se: "Integral part of this Certificate is also the Certificate of passed exams" dhe nëse përkthehet në shqip thotë: "Pjesë përbërëse e kësaj Certifikate është po ashtu Certifikata e provimeve të dhëna" Dhe jo ashtu sic e keni interpretuar ju në Vendimin e AK-së, "... Certifikata e provimeve të mbetura". Edhe numri i kredive të konfirmuara në këtë Certifikate, 240 Kredi, tregon nivelin e shkollimit.

Për sa i përket personave: Gazmend Haxhijaha, Goran Mitev, Ljupcho Tagarovski dhe Sonja Dimovska, sipas Dosjes së tenderi dhe sqarimeve shtese, vetëm për trajnerët të cilët kanë kualifikime të nryrave tjere është kërkuar që ta dëshmojnë me ndonjë certifikatë specifike se të njëjtit janë të trajnuar për të ofruar trajnime dhe on-site support. Përderisa, në Dosjen Tenderit kërkohet dëshmi:

Vendimi për Cilësinë e angazhimit, 1. Letër Referencë nga punëdhënësi dhe 2. Kopja e motorizuar e diplomës universitare, dokumente këto të cilat ne i kemi dorëzuar për secilin person veq e veq. Rrjedhimisht ky pretendim i juaji për sa i përket personave si më lart, nuk është i bazuar dhe nuk qëndron.

Me sqarimet e publikuara nga ju si AK, me datë 16.02.2023, ju keni theksuar se: Inxhinierët e elektroteknikës që kanë ndjekur studimet pesëvjeçare dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet master nuk kanë nevojë të posedojnë këtë certifikatë (e njëjta logjikë vlen për të gjitha pozicionet e tjera).

Pra sipas këtyre sqarimeve, inxhinierët e diplomuar në studimet pesëvjeçare nuk kanë nevojë të posedojnë certifikatë dhe rrjedhimisht edhe znj. Gyltene Tafa i përmbush plotësisht kriterin “Një Ekspert për kontrolle të Cilësisë.

Për znj. Sonja Dimovska: Sikurse edhe kemi deponuar me tenderin tonë, po e ri konfirmojmë se znj. Sonja Dimovska ka titullin e Inxhinieres Elektrike e diplomuar, në sistem 5 vjeçar.

Në dosjen e tenderit ne e kemi paraqitur përkthimin në gjuhën angleze, pasi që Diploma Bachelor është në gjuhën Maqedonase. - Ndërsa tek akti noterial mund të shihet qartë se ky dokument është noterizimi i diplomës së lëshuar me datë 26.12.1994 (citat:I acknowledge that this is ? ??? of the original document Bachelor Degree issued ?n 26.12.1994), që ndërlidhet me datën kur është lëshuar diploma për znj. Dimovska. Noterizimi i diplomës është kërkuar nga z. Gazmend Haxhijaha dhe për këtë arsye edhe figuron emri i z. Haxhijaha në aktin noterial.

Gjithsesi dhe kjo do të mund të sqarohet me Kërkesën për Sqarime të tenderit nga ju si AK, sikurse lejohet me LPP neni 72.

#### Përgjigja në ankesë:

**E ritheksojmë se për Edon Selimi, nuk është plotësuar dëshmia 2. Kopja e noterizuar e diplomës universitare nuk është pjese e Ofertës suaj.**

**E ritheksojmë se për Gazmend Haxhijaha, Goran Mitev, Ljupcho Tagarovski dhe Sonja Dimovska, nuk janë dorëzuar diplomat sipas kërkesës në njoftimin për kontrate dhe në dosjen të tenderit. Gazmend Haxhijaha – Elektroinxhinier, Goran Mitev – Inxhinier Elektrik, Ljupcho Tagarovski - Industrinë Elektrike, Sonja Dimovska – Inxhinier Elektrik.**

Sipas formularit standard B54 është mundësuar të dorëzohen diploma të natyrave tjera, por të janë të trajnuar për të ofruar trajnime dhe on-site support dhe ju nuk keni dëshmuar se të njëjtit janë të trajnuar për të ofruar trajnime dhe on-site support dhe diplomat e dorëzuara, me çka edhe nuk e përmbushin kërkesën sipas kërkesës në njoftimin për kontrate dhe në dosjen të tenderit.

Sipas formularit standard B54 si dokument final për vlerësim të ofertave, askund nuk thuhet që inxhinierët e diplomuar në studimet pesëvjeçare nuk kanë nevojë të posedojnë certifikatë.

Siç e kemi specifikuar edhe me lartë, në formularin standard B54 si dokumenti final për të vlerësuar ofertat për Analist Biznesi, kemi thënë “ Pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës (e njëjta logjikë vlen për të gjitha pozicionet e tjera). Inxhinierët e elektroteknikës që kanë ndjekur studimet pesëvjeçare dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet master nuk kanë nevojë të posedojnë këtë certifikatë.”. Pra kemi thënë se për të gjitha pozicionet tjera, pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës, ndërsa për Inxhinierët e elektroteknikës që kanë ndjekur studimet pesëvjeçare dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet master nuk kanë nevojë të posedojnë këtë certifikatë (PMI Professional in Business Analysis).

## Pretendimi i pestë

Kërkesa 3e. Një (1) Ekspert për Kontrollë të Cilësisë. z. Damjan Radicevic është i certifikuar ISTQB Certified Tester – Advanced Level 2012- Test Manager. ISTQB është standard botëror për kualifikimin profesional të testuesve të oftuerëve. Kjo certifikatë nuk ka nevojë të noterizohet, pasi që e njëjta mund të vërtetohet online përmes QR kodit, po ashtu sikurse edhe kërkohet në Dosjen e tenderit – “mundësia e verifikimit online” dhe se ju si AK keni mundësi në çdo kohë të bëni verifikimin e kësaj Certifikatë dhe se pretendimi i juaj është tendencioz dhe NUK qëndron.

Përveç kësaj, ne kemi angazhuar si Ekspert për Kontrollë të Cilësisë edhe znj. Gyltene Tafa, e cila është Inxhinierë e diplomuar e Elektroteknikës. Znj. Tafa ka ndjekur studimet themelore universitare sipas sistemit para-Bolonjës, sistemi pesëvjeçar.

Me sqarimet e publikuara nga ju si AK, me datë 16.02.2023, ju keni theksuar se: Inxhinierët e elektroteknikës që kanë ndjekur studimet pesëvjeçare dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet master nuk kanë nevojë të posedojnë këtë certifikatë (e njëjta logjikë vlen për të gjitha pozicionet e tjera).

Pra sipas këtyre sqarimeve, inxhinierët e diplomuar në studimet pesëvjeçare nuk kanë nevojë të posedojnë certifikatë dhe rrjedhimisht edhe znj. Gyltene Tafa i përmbush plotësisht kriterin “Një Ekspert për kontrollë të Cilësisë.

## Përgjigja në ankesë:

**Dëshmitë e dorëzuar për Damjan Radičević, nuk përmbushin kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.**

**Kërkesa ka qenë të jetë i certifikuar në Software Quality Assurance nga një institucion i akredituar, e njëjta kërkesë është korrigjuar sipa formularit standard B54 si dokument final për vlerësim të ofertave, ku është thënë “Pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës (e njëjta logjikë vlen për të gjitha pozicionet e tjera)”. Fjalja “e njëjta logjike vlen edhe për të gjitha pozicionet tjera” është për certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës.**

**Është e vërtete se për Gyltene Tafa, është dorëzuar diploma me titull Inxhinierë e Diplomuar e Elektroteknikës. Por, kërkesa në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit ka qenë “Të jetë i Diplomuar në Menaxhment dhe Informatikë, ose ekuivalente si inxhinieri softuerike, shkenca kompjuterike”.**

**Pra dëshmitë e ofruar për Gyltene Tafa nuk përmbushin kërkesat e DT. Po ashtu Gyltene Tafa nuk posedon certifikatë për Software Quality Assurance.**

**Në formularin standard B54 si dokument final për vlerësim të ofertave, është thënë” Pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës (e njëjta logjikë vlen për të gjitha pozicionet e tjera)”, pra fjalja “e njëjta logjike vlen edhe për të gjitha pozicionet tjera”, ka të bëjë me certifikimet, jo me diplomat. Ndërsa pjesa “Inxhinierë e Diplomuar e Elektroteknikës nuk kanë nevojë të posedojnë këtë certifikatë”, vlen vetëm për pozicionin Analist Biznesi, sepse askund nuk thuhet që e njëjta logjike vlen edhe për pozicionet tjera.**

### **Pretendimi i gjashtë**

Pretendimi i AK tek Specifikat teknike të DT – Aneksi 1 “AK- gëzon te drejtën te kërkoj nga OE ne afatin përcaktuar ne këtë dokument qe te krijoj edhe modulet dhe shërbime shtese pa asnjë kufizim ne kosto, apo afat kohor. - Referuar Ofertës tuaj nuk ofrohet kjo mundësi, oferta juaj gjate gjithë kohës ndërlidhet qe do te krijoj Sistem te ri, gjë qe është ne kundërshtim me kërkesën e AK-se dhe nuk mund te pranohet si zgjidhje. Ne ofertë është specifikuar qe AK e gëzon të drejtën te kërkoj nga OE ne afatin përcaktuar qe te krijojnë edhe modulet dhe shërbime shtesë pa asnjë kufizim ne kosto, apo afat kohor”.

Përgjigja: Nuk qëndron. Ne nuk kemi dhënë ofertë teknike për krijim të një sistemi të ri, përpos moduleve të reja që janë kërkuar për zhvillim (zhvillimet e reja), kemi dhënë zgjidhjen dhe planin dinamik për kohës që do i krijojmë, ndërsa për sistemin ekzistues jemi zotuar me zgjidhjen që kemi dhënë se do avancojmë (zhvillojmë) sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe do të ofrojmë mirëmbajtjen për 36 muaj (shih rreshtin e fundit të tabelës së Planit Dinamik tek propozimi teknik i mirëmbajtjes dhe avancimit).

Pretendimi i AK: Prioritet 4 – “zhvillimi i moduleve te reja jo me vone se 20 dite pune. - Sipas Ofertës tuaj ju keni ofruar zhvillim vetëm vitin e parë, gjë qe është ne kundërshtim me kërkesën e AK-se, sipas DT kërkohet qe behet Zhvillim gjate gjithë kohës sipas kërkesë se AK-se. Referuar Kërkesës se AK se kërkohet Avancim dhe mirëmbajtje e sistemit ekzistues pa ndryshuar natyrën dhe metodologjinë gjë qe kjo oferte rezulton me ndryshim nga Objektivi i projektit, ndërsa referuar ofertës tuaj rezulton se keni ofruar qe sistemi te zhvillohet nga Fillimi gjë qe është ne kundërshtim te plote me kërkesën e AK-se pasi modulet ekzistuese vetëm janë ne përdorim dhe nga te njëjtët ofrohen shërbime pa ndërprerë, andaj nga MSh nuk është kërkuar qe te ndryshoi sistemi, kjo është e Specifikuar edhe tek qëllimi i projektit "Mirëmbajta dhe Avancim e zgjidhjes ekzistuese". Referuar Ofertës Teknike nder te tjera keni deklaruar se do te ofroni një sistem softuerik... gjë qe është ne kundërshtim te plote me kërkesat e AK-se dhe dëshmon qartë se OE nuk ka ofertuar për Mirëmbajtjen dhe Avancimin e këtij sistemi mirëpo me qëllimin e krijimit te një Sistemi te Ri, kjo gjë me detaisht është e qartësuar ne faqe 48 tek Propozimi Teknik i ofertës se OE. Referuar ofertës suaj përkatësisht faqe 62 dhe 63 vërehet qartë se ju nuk do te avancoji sistemin siç është përshkruar ne dosje te tenderit, pasi referuar Planit dinamik ne faqe 63, ku potencohet se do te ofroj mirëmbajtje 36 muaj dhe nuk do te ofroj avancim ne zgjidhjen ekzistuese, andaj plani dinamik i propozuar dëshmon një gjë te tille”.

### Përgjigja në ankesë:

**Bazuar ne planin dinamik të ofertës shihet ne mënyre shumë të qartë se ju keni ofertuar për “Zhvillim” vetëm në vitin e parë. Kjo është në kundërshtim me dosjen e tenderit dhe kërkesën e AK-se ky plan dinamik dëshmon qartë se sipas kësaj oferte nuk do te mund të behet zhvillim gjatë gjithë kohës se kontratës mirëpo vetëm në vitin e parë.**

**Në kërkesat e dosjes së tenderit është specifikuar qarte “AK- gëzon te drejtën te kërkoj nga OE ne afatin përcaktuar ne këtë dokument qe te krijoj edhe modulet dhe shërbime shtese pa asnjë kufizim ne kosto, apo afat kohor” – pra, zhvillimi shtesë mund të kërkohet edhe në vitin e dytë apo të tretë.**

Autoriteti kontraktues: Ministria e Shëndetësisë | Projekti: Ritender "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" | Nr i prokurimit: 206-23-571-2-1-1

PLANI DINAMIK I REALIZIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PROJEKTIT "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS"	Viti																																						
	Viti I (i parë)												Viti II (i dytë)												Viti III (i tretë)														
	Muaji																																						
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36			
1. Nën-sistemi i pranimit (Avancim dhe Mirëmbajtje)																																							
1.1. Nën-sistemi i Orkologjisë (Zhvillim dhe Mirëmbajtje)																																							
1.1.1. Analiza e proceseve dhe procedurave																																							
1.1.2. Ridizajimi i proceseve dhe PSO																																							
1.1.3. Zhvillimi i sistemit																																							
1.1.4. Testimi i sistemit																																							
1.1.5. Implementimi i sistemit (pilota)																																							
1.1.6. Implementimi i sistemit																																							
2. Nën-sistemi i shërbimeve shëndetësore (Avancim dhe Mirëmbajtje)																																							
3. Nën-sistemi i shërbimeve të informacionit (Avancim dhe Mirëmbajtje)																																							
4. Nën-sistemi i administrimit të sistemit (Avancim dhe Mirëmbajtje)																																							
5. Nën-sistemi i fakturimit (Avancim dhe Mirëmbajtje)																																							
6. Nën-sistemi i raportimit (Avancim dhe Mirëmbajtje)																																							
7. Nën-sistemi i ndërlidhjeve (Avancim dhe Mirëmbajtje)																																							
8. Nën-sistemi i shërbimeve (Zhvillim dhe Mirëmbajtje) Të gjitha Nën-sistemet shërbimi (Faza 22 dhe 23 në doçinën tenderit) do të zhvillohet pasi të gjitha këto module të specifikohen në doçinën përfundimtare të sistemit në bashkëpunim me Departamentin e SHS për të vazhduar zhvillimin e sistemit pas versionit të parë, siç është kërkuar në doçinën e tenderit brenda periudhës së kontraktit 35 muajore.																																							
9. Sistemi i raportimeve - Intelligjencia e Biznisit (Avancim dhe Mirëmbajtje)																																							
10. Mirëmbajtja e sistemit (mirëmbajtja do të ofrohet për 36 muaj për sistemin egzistues, për të gjitha avancimet e moduleve dhe nën-sistemet dhe modulet dhe nën-sistemet e reja të zhvilluara)																																							

Legjenda:	
1.	Zhvillim
2.	Avancim dhe Mirëmbajtje
3.	Mirëmbajtje

Në emër të konzorciumit  
Hilmi Asllani, CEO- Botek shpk



**Pretendimi i shtatë**

Edhe ky pohim nuk qëndron. Ne nuk kemi dhënë zgjidhje për zhvillim vetëm për 20 dite pune dhe as nuk kemi ofertuar për krijimin e një sistemi të ri. Ne kemi dhënë ofertën për zhvillime, avancime dhe mirëmbajtje të sistemit ekzistues për 36 muaj sipas kërkesave në dosjen e tenderit. Sa i përket pretendimit tuaj se ne kemi deklaruar se ofrojmë sistem softuerik, "... tjera keni deklaruar se do te ofroni një sistem softuerik..." ne baze edhe te cilit pretendim keni ardhur ne përfundim se ne do te ofrojmë sistem te ri, nga faqja 48 e zgjidhjes tone teknike, Ky pretendim i juaji është i pavërtetë dhe tendecioz. Ne ne faqen 48 te 7. Propozimi Teknik dhe Plani i mirëmbajtjes BHIS, flasim për Mirëmbajtjen dhe procesin e mirëmbajtjes, dhe jo për zhvillimin e një sistemit te ri.

Nga faqja 48, Mirëmbajtja:

Gjatë kësaj periudhe, Kontraktuesi do të identifikoj dhe zgjidhë problemet për të siguruar funksionimin adekuat të sistemit. Kontraktuesi duhet të ofroj një sistem softuerik, efektiv për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale. Gjatë kësaj periudhe, Grupi i Operatorëve Ekonomik deklaror se do të identifikoj dhe do te zgjidhë problemet për të siguruar funksionimin adekuat të sistemit. Grupi i Operatorëve Ekonomik do të ofroj një sistem softuerik, efektiv për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale.

Pra ne menyre qe te ofrojme mirembajtje me efektive per lajmerimin dhe monitorimin e zgjidhjes se problemeve eventuale, ashtu sic e keni kerkuar ju decidivisht ne dosjen e tenderit faqe 24 e dosjes se tenderit, ne do te kemi nje sistem softuerik per Mirembajtje, dhe kjo nuk ka te beje fare me vete Aplikacionin e BHIS Pjese nga faqja 24 e dosjes se tenderit: 13. MirëmbajtjaKontraktuesi do të

sigurojë mbështetje dhe mirëmbajtje pas lançimit të suksesshëm të çdo pjese të sistemit, për aq kohe sa posedon Kontrate Aktive. Gjatë kësaj periudhe, Kontraktuesi do të identifikoj dhe zgjidhë problemet për të siguruar funksionimin adekuat të sistemit. Kontraktuesi duhet të ofroj një sistem softuerik, efektiv për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale. Operatori Ekonomik është i detyruar të sigurojë një prezencë fizike kur është e nevojshme për të eliminuar ndonjë mangësi apo parregullsi të sistemit

Bashkangjitur keni Excel Fajllin me titull "Plani i realizimit te projektit BHIS sipas kerkesave.xlsx" që e keni të inkuorporuar në propozimin teknik referuar ofertës sonë përkatësisht faqeve 62 dhe 63 vërehet qartë nuk qëndron se ne nuk do te avancojmë sistemin siç është përshkruar ne dosje te tenderit, por edhe referuar Planit dinamik ne faqe 63 mund ta vëreni në planin dinamik në Excel Fajll të zhvillimeve, avancime dhe mirëmbajtjes, se çdo fazë në kuadër të 36 muajve është konfom dosjes së tenderit si në vijim:

#### PLANI DINAMIK I REALIZIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PROJEKTIT "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS":

1. Nën-sistemi i pranimit: (Avancim dhe Mirëmbajtje) 10 muaj, vazhdon pastaj me ngjyrë të gjelbërt mirëmbajtja deri në fund të projektit pas zhvillimit dhe avancimeve për muajt e mbetur deri në përfundim të 36 muajve sa do të zgjatë projekti/kontrata.
2. Nën-sistemi i shërbimeve shëndetësore (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
3. Nën-sistemi i shërbimeve të infermierisë (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
4. Nën-sistemi i administrimit të sistemit (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
5. Nën-sistemi i faturimit (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
6. Nën-sistemi i raportimit (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me me ngjyrë të verdhë në Excel fajll.
8. Nën-sistemet shitesë (Zhvillimi dhe Mirëmbajtje) Të gjitha Nën-sistemet shitesë (Faqe 22 dhe 23 në dosjen e tenderit) do të zhvillohet pasi të gjitha këto module të specifikohen në detaje gjatë implementimit të sistemit në bashkëpunim me Departamentin e SISH për të vazhduar zhvillimin e sistemit pas versionit të pare, siç është kërkuar në dosjen e tenderit brenda periudhës së kontratës 36 mujore.
9. Sistemi i raportimeve - Inteligenca e biznesit (Avancim dhe Mirëmbajtje) 36 muaj me ngjyre të verdhë në Excel fajll.
10. Mirëmbajtja e sistemit (mirëmbajtja do të ofrohet për 36 muaj për sistemin ekzistues, për të gjitha avancimet e moduleve dhe nën-sistemet dhe modulet dhe nën-sistemet e reja të zhvilluara), referojuni ngjyrës së gjelbërit në Excel fajll për 36 muaj mirëmbajtje për 9/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK tërë sistemin ekzistues dhe modulet e krijuara që do zhvillohen të reja dhe avancimet.

Prandaj, bazuar në të gjitha sqarimet që u dhanë më lartë, të bazuara gjithmonë me prova materiale, mund të konstatojmë që vendimi juaj i datës 25.04.2023 është i jashtëligjshëm. Prandaj, kërkojmë nga ju që të anuloni vendimin e datës 25.04.2023 dhe lëndën ta ktheni në rivlerësim

Përgjigja në ankesë:

Referuar Dosjes se ofruar përkatësisht ne planin dinamik te ofertuar shihet ne mënyre shume te qarte se ju keni ofertuar për “Zhvillim” vetëm ne vitin e pare. Kjo është e pa pranueshme dhe pranimi eventual i këtij plani dinamik do te dëmtonte rende te gjithë procesin e implementimit te projektit.

Ne kërkesat e dosjes se tenderit është specifikuar qarte “AK- gëzon te drejtën te kërkoj nga OE ne afatin përcaktuar ne këtë dokument qe te krijoj edhe modulet dhe shërbime shtese pa asnjë kufizim ne kosto, apo afat kohor” – pra, zhvillimi shtesë mund të kërkohet edhe në vitin e dytë apo të tretë dhe ai sipas dosjes së tenderit duhet të realizohet gjatë gjithë periudhës kontraktuale (36 muaj).



Autoriteti kontraktues: Ministria e Shëndetësisë | Projekti: Ritender "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" | Nr i prokurimit: 206-23-571-2-1-1

PLANI DINAMIK I REALIZIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PROJEKTI "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS"	Viti																																						
	Viti I (i parë)												Viti II (i dytë)												Viti III (i tretë)														
	Muaji																																						
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36			
1. Nivë sistemit i përcaktuar (Avancim dhe Mirëmbajtja)																																							
1.1. Nivë sistemit i Çrëklogjishë (Zhvillim dhe Mirëmbajtja)																																							
1.1.1. Analiza e proceseve dhe procedurave																																							
1.1.2. Ridizajoni i proceseve dhe FSO																																							
1.1.3. Dizajni i sistemit																																							
1.1.4. Testimi i sistemit																																							
1.1.5. Implementimi i sistemit (përfundim)																																							
1.1.6. Implementimi i sistemit																																							
2. Nivë sistemit i shërbimeve shëndetësore (Avancim dhe Mirëmbajtja)																																							
3. Nivë sistemit i shërbimeve të informacionit (Avancim dhe Mirëmbajtja)																																							
4. Nivë sistemit i administrimit të sistemit (Avancim dhe Mirëmbajtja)																																							
5. Nivë sistemit i fakturimit (Avancim dhe Mirëmbajtja)																																							
6. Nivë sistemit i raportimit (Avancim dhe Mirëmbajtja)																																							
7. Nivë sistemit i ndërrindjeve (Avancim dhe Mirëmbajtja)																																							
8. Nivë sistemit shtesë (Zhvillim dhe Mirëmbajtja) Të gjitha nivë sistemit shtesë (Faqe 22 dhe 23 në dosjen tenderit) do të zhvillohet pasi të gjitha këto modult të specifikohen në detaje gjatë implementimit të sistemit në bashkëpunim me Departamentin e SHIS për të vazhduar zhvillimin e sistemit pas versionit të parë, siç është diskutuar në dosjen e tenderit brenda periudhës së kontratës 36 muaj.																																							
9. Nivë sistemit i raportimeve - Intelligjencia e biznesit (Avancim dhe Mirëmbajtja)																																							
10. Mirëmbajtja e sistemit (Mirëmbajtja do të ofrohet për 36 muaj për sistemin e gëzimit, për të gjitha avancimet e modulteve dhe nivë sistemit dhe modulteve dhe nivë sistemit teja të zhvilluar)																																							

Legjenda:	
1.	Zhvillim
2.	Avancim dhe Mirëmbajtja
3.	Mirëmbajtja

Në emër të konzorciumit  
Hilmi Asllani, CEO- Botek shpk



**Për më shumë, po ri-paragesim kërkesat për të cilat nuk kemi pranuar kërkesë për ri-shqyrtim, përkatësisht pikat me numër 1 dhe 2 të vendimit:**

1. Operatori ekonomik duhet të implementojë po ashtu një sistem raportimi (Business Intelligence) i cili duhet të jetë një platformë në web (jo Excel ose mjete të ngjashme), i



pavarur nga sistemi i informative shëndetësore, në mënyrë që të mos ndikojë në performancën e sistemit. – **Oferta e juaj nuk përkon me kërkesën dhe teknologjinë e kërkuar, rrjedhimisht nuk përmbushet kërkesa e dosjes së tenderit.**

**Ritheksojmë që oferta juaj nuk përkon me teknologjitë e kërkuara.**

Tek seksioni “Teknologjitë me të cilat është zhvilluar sistemi” është bërë shfaqja e teknologjive me të cilat është ndërtuar platforma dhe brenda tyre gjenden edhe teknologjitë e përdorura për dizajnimin e sistemit dhe komponenteve tjera si raporteve dinamike.

Brenda po të njëjtës kërkesë, njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit është theksuar si vijon:

*“Raportet duhet të mundësohet të dizajnohen në formë dinamike, që do të thotë se përdoruesit duhet të jenë të lirë t'i prodhojnë ato sipas nevojave të tyre.*

*Pas prodhimit të raporteve, ata duhet të kenë mundësinë e vizualizimit në grafikët e ndryshëm ose në hartë.”*

**Shkeputur nga Dosja e tenderit:**

***Sistemi i raportimeve - Inteligjenca e biznesit (Avansim dhe Mirëmbajtje)***

*Operatori ekonomik duhet të implementojë po ashtu një sistem raportimi (Business Intelligence) i cili duhet të jetë një platformë në web (jo Excel ose mjete të ngjashme), i pavarur nga sistemi i informative shëndetësore, në mënyrë që të mos ndikojë në performancën e sistemit.*

*Raportet duhet të mundësohet të dizajnohen në formë dinamike, që do të thotë se përdoruesit duhet të jenë të lirë t'i prodhojnë ato sipas nevojave të tyre.*

*Pas prodhimit të raporteve, ata duhet të kenë mundësinë e vizualizimit në grafikët e ndryshëm ose në hartë.*

*Paneli (dashboard) duhet të personalizohet, që do të thotë se çdo shfrytëzues duhet të ketë akses, përkatësisht informacione nga fushat e tij / saj dhe duhet të zhvillohet me mjete të reja teknologjike për të arritur përshtatshmërinë dhe intuitën e zgjedhjes.*

## Në ofertën e juaj për këtë aktivitet të prokurimit keni paraqitur:

Sistemi do të përfshijë një numër raportesh standarde që do të specifikohen nga përfituesi dhe gjithashtu do t'i mundësojë përdoruesit të krijojë raportet e veta, duke përdorur një mjet Microsoft Reporting Services - RDLC. Sistemi do të jetë në gjendje të gjenerojë lloje të ndryshme të raporteve përmbledhëse që tregojnë statistikën bazë të punonjësve të paraqitura në formën e grafikëve, të gjenerojë lloje të ndryshme raportesh përmbledhëse në formate të ndryshme dhe në formatin e listës nga modulet e sistemit, p.sh. për dokumentet e lëshuara, dokumentet në përdorim, kutitë, etj. Sistemi do të lejojë printimin në ekran të raporteve, raporteve të përcaktuara nga përdoruesi, etj.

Raportet do të mund të eksportohen në formatet e mëposhtme:

- XML,
- PDF,
- Skedari TIFF,
- Arkivi Ueb,
- Excel,
- fjalë,
- CSV

Sistemi që do të zhvillohet nga grupi i operatoreve ekonomike, do të jetë i pasur me paraqitje vizuale të të dhënave. Disa nga llojet e grafikëve grafikë që mund të përdoren për të shfaqur performancën e komunave të paraqitura në fotot e mëposhtme:

**Bazuar në ofertën tuaj ju ktheni theksuar se do të ofroni raporte standarde gjë e cila nuk është kërkuar përmes dosjes së tenderit dhe njëkohësisht në zgjidhjen e ofruar ktheni ofertuar raportet dinamike përmes RDLC.**

Ju njoftojmë se kjo zgjidhje (RDLC) është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit ngase RDLC është vegël e Microsoft e cila shërben për dizajnimin e raporteve nga zhvilluesi/dizajneri/programeri dhe pastaj ato raporte mund të përdoren nga përdoruesi i sistemit, ku në këtë rast janë personeli mjekësor (doktori, motra medicinale, ...) të cilët janë përdorues pa bagazh teknik.

Kjo zgjidhje gjene zbatim në sistemin tonë në komponentë tjera por që përmes kësaj teknologjie nuk ofrohet mundësia e dizajnit të raporteve dinamike sic kerkohet edhe ne DT që do të thotë se përdoruesit duhet të jenë të lirë t'i prodhojnë ato sipas nevojave të tyre siç edhe ka qenë kërkesë e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit dhe njëkohësisht sipas ofertës suaj nuk mundësohet implementim i inteligjencës së biznesit (Business Intelligence).

Për më shumë, ju nuk keni konfirmuar teknologjitë as tek pjesa "Teknologjitë me të cilat është zhvilluar sistemi" por se keni theksuar se zhvillimin e aplikacionit do ta realizoni përmes ASP.NET frame me model MVC dhe nuk keni paraqitur asnjërën nga teknologjitë tjera që nevojiten për komponentët tjera të sistemit e që janë theksuar qartë në kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

### Përgjigja që është dhënë nga ju është si vijon:

Për zhvillimin e këtij aplikacioni do të përdoret Asp.NET frame me model MVC. Arsyeja kryesore pse modeli MVC do të përdoret është për shkak të mundësisë që krijon në ndarjen e funksionalitetit me tre nivele në Controller, Model dhe View. Përdorimi i këtij kuadri për zhvillimin e këtij aplikacioni do të mundësojë krijimin e aplikacionit me një performancë jashtëzakonisht të lartë në trajtimin e kërkesave të klientëve. Krahasuar me platformat e tjera të zhvillimit të uebit, Asp.NET MVC performon shumë më mirë se pothuajse çdo platformë tjetër.

Logjika e ruajtjes së të dhënave në bazën e të dhënave bazohet në qasjen e parë të bazës së të dhënave, në mënyrë që bazat e para të të dhënave të dizajnohen duke përfshirë relacionet përkatëse. Pastaj i njëjti model pasqyrohet në logjikën e apikimit në klasa. Modeli i gjeneruar nga baza e të dhënave do të mundësojë qasje të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave me kontekst specifik që do të krijohet. Object-Relational Mapper (O/RM) që do të përdoret për aksesin e të dhënave në Entity Framework MVC, i cili paraqet kornizën më të fundit të .NET MVC për manipulimin e të dhënave në bazën e të dhënave. Klasat që krijohen nga Entity Framework MVC, do të përdoren për të manipuluar drejtpërdrejt në tabela në bazën e të dhënave.

Siguria e aplikacionit do të bazohet në kornizën bazë asp.net e cila është krijuar ekskluzivisht për menaxhimin e përdoruesve, grupeve dhe aksesin dinamik në pjesë të caktuara të aplikacionit. Autentifikimi do të aktivizohet përmes skemës Cookie-Authentication, ndersa autorizimi do të bazohet në skemën e bazuar në politikë. Çdo përdorues në aplikacion do të trashëgojë vetitë dhe akseset nga grupi ose grupet të cilave i përket.

Faqe 42 / 63

2. Kërkohej që operatori ekonomik të ketë staf të specializuar dhe përvojë në zbatimin e së paku dy (2) sistemeve të raportimit, të paktën në një organizatë me mbi 100 punonjës, dhe ta vërtetojë atë me një raport pranimit ose referencë nga autoriteti kontraktues. – Referuar dosjes se ofruar për këtë aktivitet të prokurimit nuk keni ofruar asnjë dëshmi për këtë kërkesë

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

#### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

#### Vendimi i dorëzohet:

1. Botek SHPK
2. Operatoreve ekonomik të interesuar

  
Berat Marmullaku  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

